



RAPORT

Sektori I Antitrafikimit Dhe Mbeshtetjes Se Grave

Janar- Maj 2009

Pregatiti
ARIELA MITRI
KOORDINATORE E PROJEKTIT

HYRJE E PROJEKTIT

Ne kuadrin e grupeve ne nevoje lindi ne 2005 projekti « KONGREGATAT KATOLIKE KUNDER TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJEREZORE » i cili ka si qellim parandalimin e trafikimit te qenieve njerezore ne shoqerine shqiptare.

Zhvillimi i ketij projekti konsiston ne sensibilizimin e shoqerise shqiptare per kete fenomen me ane te formimeve te ndryshme, takimeve, materialeve te publikuara dhe aktiviteteve neper qendrat katolike ne te gjitha vendin. Te gjitha jemi te perfshire ne kete problematike. Nuk mjafton te angazhohemi vetem ne parandalimin e trafikimit por edhe ne asistencen dhe reintegrimin e viktimave te trafikut.

Projekti qe po implementohet aktuakisht eshte nje vazhdimesi e « **Kongregatave Katolike Kunder Trafikimit te Qenieve Njerezore I** » dhe mbeshtet ne menyre direkte zbatimin e **Strategjise Kombetare Shqiptare Per Luften Kunder Trafikimit te Qenieve Njerezore 2008-2010** te hartuar nga zyra e Koordinatorit Kombetar i cili ka dhe pozicionin e Zevendes Ministrit te mbrendshem dhe organizatave qe punojne ne kete fushe .

Kryesisht eshte fokusuar per

-Te rritur investimet edukative , qofshin ato qeveritare ose jo, te mediave dhe programeve te tjera jashte kufijve te cilat sherbejne per informimin dhe edukimin e popullsise vecanerisht te grave, femijeve, dhe grupeve te tjera shoqerore te cilat jane te ekspozuara ndaj rreziqeve te trafikimit.

- te zhvillojme prospekte per nje perfshirje me te madhe sociale ne sektoret me te ndjeshem te shoqerise sone dhe perdorimin e alternativave te pa perdorura me pare rreth trafikimit dhe antitrafikimit.

Projekti i propozuar fokusohet se tepermi ne permiresimin e kapaciteteve te Caritas-it Shqiptar per rritjen e informacioneve te marra rreth trafikimit, te marri pergjigje te planifikuara per te parandaluar trafikimin. Si dhe duke i mbajtur larg rreziqeve grate dhe femijet duke i ofruar alternativa te cilat do te mbeshtesin informimin e tyre nepermjet skemavete miniprojekteve qe do te zhvillohen gjate projektit.

Projekti do te mbeshtesi gjithashtu perpjekjen e Caritasit per advokatsi ne nivele te ndryshme gjithashtu duke lehtesuar shkembimet ndermjet institucioneve fetare ose jo fetare ne Shqiperi dhe ne rajon.

Caritas Shqiptar eshte implementuesi i ketij projekti duke bashkepunuar me Caritaset dioqezane dhe komunitetet fetare ne te gjitha Shqiperine. Motrat dhe operatoret dioqezane punojne ne terren per te zhvilluar aktivitetet por duke pasur mbeshtetjen nga zyra e projektit ne Caritas Shqiptar.

DONATORE : *ky projekt eshte financuar nga SECOUR CATHOLIQUE- CARITAS FRANCE dhe CRS*

Projekti i antitrafikimit eshte nje projekt ku aktoret kryesore ne implementimin e tij jane caritaset Dioqezane dhe kongregatat Katolike ne te gjitha vendin por dhe

nje aspekt tjetër i rëndësishëm për tu përmendur është dhe bashkëpunimi me Diakonione Agape dhe Kishën Protestante. Ky bashkëpunim ka lindur që në 2007 falë vullnetit dhe angazhimit të tre përfaqësuesve të organizatave.

1. Projekti : « **Kongregatave Katolike Kunder Trafikimit të Qenieve Njerezore** »

- Edhe këtë vit projekti është fokusuar në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore duke organizuar aktivitete sociale kulturore për grup moshë të ndryshme në çdo Diqe. Stafit i sektorit të antitrafikimit ka si praktikë punë që planin e aktiviteteve që do të implementohen gjatë vitit nëpër dioqeza e organizon bashkë me Drejtoret dioqezanë dhe përfaqësuesit e caritaseve dioqezane.

Të cilët e mirëpresin këtë takim dhe shprehin vazhdimësinë e bashkëpunimit me sektorin tonë. Mbetet gjithmone problem Caritasi dioqezanë I Lezhës dhe I Jugut, pasi dhe në projektin e vjetër nuk është bashkëpunuar në organizimin e aktiviteteve.

- **BKTF = Bashkë Kunder Trafikimit të Femijeve**

Që prej 18 dhjetorit të 2008 Caritas Albania është pjesë e këtij koalicioni i cili është me i madhi në vend. Mbrojtja e gjithanshme e të drejtave të fëmijëve mbetet një sfidë për shoqërinë shqiptare. Një numër i madh fëmijësh shqiptarë vazhdojnë të vuajnë forma të ndryshme dhunimi të të drejtave të tyre nga fenomene si trafikimi, shfrytëzimi dhe abuzimi. Për të luftuar këtë fenomen, një numër i madh institucionesh shtetërore, organizatash qeveritare dhe jo-qeveritare punojnë për të zhvilluar një rrjet i cili siguron mbrojtjen e fëmijëve. Disa nga këto organizata, për të koordinuar më mirë përpjekjet e tyre për mbrojtjen e fëmijëve, kanë themeluar një koalicion të quajtur “Së bashku kundër Trafikimit të Fëmijëve” (BKTF) Lajtmotivi drejtues i këtij koalicioni është të veprojë me vendosmëri dhe përkushtim “në përputhje me parimet e interesit më të lartë të fëmijës”. Koalicioni i BKTF-së përbëhet nga njëzet e dy organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat kryejnë aktivitetet e tyre gjatë gjithë vendit duke asistuar dhe mbrojtur fëmijët vulnerabël në Shqipëri. Në terma gjeografike, anëtarët e BKTF-së punojnë në qytete si Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça, Shkodra, Fieri, Vlora, Kukësi, Berati, Gjirokastra etj. Koalicioni mbështetet dhe nga një Bord Këshillues i cili përbëhet nga Ministria e Brendshme, Ministria e Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, OSBE, UNICEF, ILO, USAID, IOM dhe KVKTNJ. Qëllimi i këtij koalicioni është të përfitojë nga eksperiencia e anëtarëve të tij dhe të bashkojë forcat në advokim për zhvillimin e strategjive kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve, krijimin dhe zbatimin e mekanizmave mbrojtës për fëmijët dhe përmirësimin e shërbimeve për fëmijët e trafikuar, abuzuar, apo të shfrytëzuar si dhe fëmijëve në rrezik..

BKTF ka kontribuar në hartimin e disa dokumenteve thelbësore si: *Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikut* dhe *Standardet e Shërbimeve Sociale për Fëmijët dhe për Personat e Trafikuar*. Për më

tepër, koalicioni ka luajtur rol si në hartimin ashtu dhe në advokimin për nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj greke në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve shqiptarë të trafikuar në Greqi.

- Gjithashtu me date **27 dhe 28 shkurt 2009** ne Caritas Albania u organizua nje seminar me teme « *TRAFIKIMI I FEMIJEVE NE SHQIPERI - MJETET DHE METODAT PER TE PARANDALUAR KETE FENOMEN* » ku moren pjese perfaqesues nga Caritaset dioqezane te cilet punojne neper qendra me grupmosha te ndryshme. Te ftuar si lektor ishin : koordinatorja e BKTF zonja Danjela Shkalla e cila paraqiti punen dhe rolin qe ka BKTF per parandalimin e trafikimit, dhe zonja Eliona Kulluri pedagoge e Fakultetit te Shkencave sociale e cila shpjegoi metodat e intervistimit dhe keshillimit. Gjithashtu u be nje rifreskim i shkrimit dhe raportimit te miniprojekteve te cilat nisin tani ne muajin mars.
- Jane realizuar **vizita** ne dioqezat ku jane financuar mikroprojektet dhe konkretisht ne zonen e Shkodres. Mikroprojekt jane financuar nga projekti i antitrafikimit dhe fuqizojne grate dhe vajzat ne risk per tu trafikuar. Konkretisht jane 2 mikroprojekte ne Trush dhe ne Rranxe ku vajzat pervec formimit profesional marrin dhe nje formim per jeten. Trajtohen tema te ndryshme me karakter social. Aktiviteti i tyre ekonomik mbeshtet nga murgeshat te cilat kane vene ne dispozicion ambjentet e tyre dhe i ndihmojne per shitjen e materialeve te prodhuara. Eshte nje projekt i ndjekur me shume interes pasi kete gra jetojne ne zona malore dhe me nje situatë ekonomike mjaft te veshtire, gjithashtu dhe mentaliteti i zones eshte i mbyllur dhe nuk i lejon grate te integrohen si duhet ne shoqeri. Prezenca e murgeshave dhe mundësia e pjesmarrjes ne kete projekt ekonomik i ka ndihmuar keto vajza dhe gra te dalin sado pak nga situata e tyre. Kerkohet mbeshtetje dhe vazhdimesi per keto vajza sepse projekti eshte i limituar ne buxhet.
- Gjate kesaj periudhe eshte bashkepunuar me BKTF sepse iu dha mundësia te jete nje aktor teper i rëndësishem ne procesin e hartimit te raportit alternativ. Ky proces konsiston ne kontributin dhe ndarjen e informacioneve te rëndësishme mbi punen e bere per mbrojtjen e femijeve dhe zbatimin e konventes se te drejtave te tyre. Ky raport behet nje here ne pese vjet dhe dorezohet ne Geneve. Behet ne dy kopje nje e pregatit qeveria, zyra pergjegjes dhe nje e pregatit shoqeria civile e cila punon konkretisht ne terren. Konsistonte ne mbledhjen e te dhenave rreth zbatimit te drejtave te femijeve nga shteti duke u bazuar ne disa nene. Edhe Caritas Albania ishte prezent dhe kontribuoi me disa materiale. Per shume do te shikojme raportin kur te publikohet.

- Pjesmarrje ne WORKSHOP: **23/03/09**

“Rendesia e bashkepunimit ndersektorial ne mbrojtjen e femijeve ne Shqiperi ”

Me pjesmarrës të veçantë nga:

Z. Genc Pollo, zv/Kryeministër i Shqipërisë; Znj.Marjeta Zaçe, Zv/Ministër MPÇSSH; Z.Ahmet Premçi, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Workshopi u realizua në kuadër të bashkëpunimit që UNICEF dhe CRCA / DCI Shqipëri kanë ndërmarrë në drejtim të ngritjes së Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri. Linja Kombëtare e Telefonit konsiston në ngritjen e shërbimit të parë falas kombëtar të telefonit për fëmijët në të gjithë Shqipërinë. Ajo do të jetë në dispozicion të çdo fëmije, nëpërmjet këshillimit dhe ndihmës në raste emergjente, 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës.



2. Ne kuader te projektit “ **Komunitetet Fetare te Krishtera se bashku ne perballjen e trafikimit te qenieve njerezore**” me date 23 janar 2009 u organizua nja takim formues dhe informues me pjesmarres te tre besimeve ortodoks, katolik dhe ungjillor. Ky takim eshte vazhdimesi e takimeve formuese. Tema kryesore e dites ishte : “*Situata e trafikimit te femijeve ne vend dhe roli I BKTF ne permiresimin e situates*” gjithashtu puna u fokusua ne dy drejtime kryesore: - Roli I kishave per kete problem, - si mund te punojme per parandalimin e trafikimit. Te gjithe pjesmarresit e vune theksin tek rendesia e parandalimit dhe asistences se personave ne nevojë. Si rezultat I ketyre takimeve ka qene koordinimi I disa aktiviteteve te perbashketa ne ndihme te rasteve ne rrezik dhe publikimi I shume materialeve sensibilizuese te cilat do te shperndahen neper qendra te ndryshme per tu ardhur ne ndihme animatoreve qe punojne me grupe te ndryshme.

- Pas formimit te organizuar ne muajin Janar grupi i punes ka lexuar me vemendje vleresimin e bere nga pjesmarresit dhe ka pare qe te tre grupet insistojne ne vazhdimesine e ketij bashkepunimi kunder trafikimit te qenieve njerezore. Kryesisht ne :
 - sensibilizimin e e komuniteteve fetare
 - pune me grupe te ndryshme si gra, vajza, femije dhe familje
 - aktivitete artistike ne koalicion
 - publikime
 - kampe verore te perbashketa me kete teme
 - trajnime dhe seminare
 - njohjen me te mire komunitetit dhe fuqizimin e tij.

Per kete u hartuar nje plan pune i perbashket per muajt ne vijim : - takim me studentet ne qytetin studenti/ - takim me operatore sociale te tre besimeve/ - dhe takim me grupin e perbashket te lutjes.

1. Aktiviteti me studentet u organizua me date 26 mars ora 17:00-20:00 ne ambientet e kishes Ortodokse ne Qytet Studenti. Ishin te pranishem rreth 60 te rinj perfaqesues te tre besimeve te cilet u informuan per situaten e trafikimit si problem qe prek rinine shqiptare dhe ne vecanti studentet si persona ne risk. E ftuar per kete takim ishte Drejtoresha e zyres antitrafikim ne Ministrine e brendshme Zonja Irena Taga.

2. Organizimi i trajnimit dy ditor ne datat 2-3 prill me teme: "Trafikimi i femijeve plage e dhimbshme per shoqerine shqiptare" ne bashkepunim me Dioakonine Agape, Caritas dhe Kisha protestante. Ketu pjesmarresit vinin nga zona te ndryshme te vendit dhe kishin kontakte direkte ne terren me persona ne risk.



GRATE NE VESHTIRESI

Rastet e asistuar nga projekti i Grave ne Veshtiresi

1. I.M. vajze/ nene me nje femije nje vjec, e ndare nga burri me te cilin bashkejetonte per nje periudhe te shkurter kohe. Pa pune dhe probleme me strehimin. Kerkonte ndihme per ilace per femijen e semure. Eshte ndihmuar per te blere ilacet.
2. V.H. nje grua me dy femije e cila eshte larguar nga shtepia per arsye te dhunes ne familje. Per nje kohe te shkurter ka jetuar tek te afermit por tani eshte pambeshtetje per strehim. Eshte ndihmuar ne pagesen e strehimit.
3. D.M. probleme ekonomike per perballimin e situates familjare ne te cilen ndodhet familja e saj.
4. K.N. vajze ere me disa semundje te renda dhe me nje situatë ekonomike te veshtire qe nuk e lejon te bleje ilacet cdo muaj. Eshte ndihmuar te bleje ilacet.
5. M.B. grua e veje, e larguar nga shtepia pasi nuk shkonte dakord me vjehrrin. Probleme te shumta shendetesore dhe ekonomike dhe pamundesi per te gjetur nje strehim. Ndhimohet per te paguar qerane.

AKTUALISHT PUNA ESHTË FOKUSUAR NE :

1. Fushaten kunder shfrytezimit te femijeve ne nivel kombetar :

Objektivat e Fushates

- 1) Te zhvillohet ndergjegjesimi i publikut mbi shfrytezimin e femijeve qe punojne e jetojne ne rruge per pune

- 2) Te advokohet me partite politike per perfshirjen e ceshtjeve te mbrojtjes se femijeve qe punojne e jetojne ne rruge nga shfrytezimi ne platformen e tyre politike, duke konsideruar procesin elektoral te ketij viti.
- 3) Te nxitet pushteti qendror dhe vendor per marrjen e masave konkrete dhe ndertimin e mekanizimit kombetar per mbrojtjen e ketyre femijeve.
- 4) Te advokohet ne pushtetin qendror dhe lokal per mbeshtetjen me fonde per zbatimin e ketyre masave.
- 5) Te advokohet per hartimin dhe zbatimin e politikave sociale per femijet qe punojne e jetojne ne rruge.

Grupet e fokusit (target group)

Eshte vene re qe grupi me vulnerabel i femijeve te cileve i dhunohen shume te drejta eshte grupi i femijeve te cilet punojne e jetojne ne rruge. Per kete arsye fushata do te fokusohet ne ndergjegjesimin e publikut dhe strukturave te ndryshme shteterore per mbrojtjen e ketij grupi nga forma te ndryshme te shfrytezimit.

Ke do te targetoje fushata?

Fushata do te synoje te targetoje ato aktore te cilet kane nje ndikim te drejtperdrejte apo dhe indirekt ne ndryshimin e situates se femijeve te cilet punojne e jetojne ne rruge.

- Komuniteti (familja, te aferm, etj)
- Media e shkruar dhe elektronike
- Shkollat dhe kopshtet (Stafi i tyre)
- Partite politike
- Qeveria qendrore
- Qeveria Lokale
- Votuesit ne teresi

Perfituesit e fushates

- Perfitues kryesore do te jene femijet qe punojne e jetojne te cilet vuajne apo rrezikojne forma te ndryshme shfrytezimi
- Publiku i gjere i cili do te informohet mbi menytrat dhe hapat qe mund te ndermerren per mbrojtjen e ketyre femijeve
- Strukturat shteterore (qendrore e lokale) te cilet do te sensibilizohen mbi fenomenin e konsiderojne ate me shume ne nivel planesh politik e financiar.

Caritas Albania do ta shtriye kete Fushate ne nivel Kombetar fale punes qe po bejne Caritaset Dioqezane neper qendra te ndryshme duke organizuar aktivite per daten 1 dhe 12 qershor 09.

2. MINIPROJEKTET

Ka mbaruar procedura e dorëzimit te miniprojekteve nga caritaset dioqezave dhe po behen transfertat bankare per Cdo zyre dhe me pas implementimi i aktiviteve te propozuara.

3. LIBRI

Stafi i sektorit po punon te publikoje ne fund te vitit nje liber me materiale dhe teknika te ndryshme per aktivitete qe do te organizojne neper qendra kunder trafikimit dhe per parandalimin e ketij fenomeni. Libri do te jete edhe nje udhezues per animatoret dhe operatoret.

4. VULLNETARET

Ka nje bashkepunim me fakultetin e shkencave sociale ku do te kete vazhdimisht prane sektoreve ne Caritas studente te kesaj fusha te cilet do te bejne praktiken dhe do te japin kontributin e tyre ne organizimin e aktiviteve.

FOTO

